



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:293460

Datë: 21.02.2025

Numri i dokumentit: 06884469

C.nr.5064/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, nëpërmjet gjyqtarit Agron Karatash, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional L.Ç. në çështjen juridike të paditësit Sh.K. nga Prizreni, me numër personalë të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prizreni, kundër të paditurit Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti Kompensimi i pagave jubilarë, gjykata me datë 21.02.2025, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit Sh.K. me të cilën ka kërkuar kompensimin e pagës jubilarë, ashtu që, **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit që në emër të Kompensimit të pagës jubilarë të kompensojë shumën prej 135.77 euro, në emër të 50% të pagës bazë (271.55euro) të punëtorit teknik, për 10 vite përvojë pune, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë (22.11.2023), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit në shumën prej 48.09 euro, si e pabazë.

III. OBLIGOHET e paditura Komuna e Prizrenit, që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë shumën prej 125 euro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Arsyetim

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate me 22.12.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar kompensimin e pagave jubilarë, konkretisht 50% të pagës bazë për 10 vite përvojë pune dhe atë shumën prej 183.87 euro, konform Kontratës Kolektive të vitit 2017 dhe 2021. Shpenzimet gjyqësore i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi të paraqitur me datë 24.09.2024, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Ka theksuar se pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i pagës

bazë është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, pasi që në këto dispozita shkruan kjo për përfituesit e të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga kjo kontratë, ndërsa paditësi nuk ka ofruar prova që është anëtarë i sindikatës dhe i ka kaluar procedurat administrative sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës dhe nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, po ashtu me këto veprime i shkakton Komunës së Prizrenit shpenzime të mëdha, sepse e obligon që t'ia paguajë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Po ashtu thekson se në mungesë të alokimit të mjeteve nga Ministria e Arsimit, e paditura nuk mund të veproj në kundërshtim me planifikimin buxhetor. Gjithashtu ka theksuar se pretendimet e paditësit janë në kundërshtim me nenin 90 para.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarave, dhe në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënës dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate, andaj nga të gjitha të cekurat ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është i punësuar në SHF ‘‘Abdyl Frashëri’’, në Prizren, vërtetuar përmes vërtetimit me numër 418, të datës 14.11.2023, me të cilën shihet se paditësi ka gjithsej 11 vite përvojë pune.

Bazuar në faktet e çështjes, më saktësisht duke marrë për bazë periudhën se kur paditësi ka arritur vitin jubilar, Gjykata gjen se zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017.

Me nenin 35 par.8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është paraparë se *‘‘Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: 8.1 për 10 vite të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë, 8.5 Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, ku i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve të nenit 8’’*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtor në sistemin arsimor, t'ia paguaj kompensimin e pagës jubilarë, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës, duke i njohur shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me këtë, gjykata ka vendosur që t'ia njeh të drejtën e kompensimit të pagave jubilarë, dhe atë të kompensojë shumën prej 135.77 euro, në emër të 50% të pagës bazë (271.55euro) të punëtorit teknik, për 10 vite përvojë pune, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë (22.12.2023), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestuese, ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesë padinë”* dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga e paditura, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi ka qenë në marrëdhënie të punës tek e paditura.

Andaj, bazuar në dispozitat e Nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, ndërsa shumat e kompensimit vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Në anën tjetër, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar kërkesën e paditësit përtej shumës së gjykuar dhe atë për 48.09 euro, si të pabazë, pasi që i njëjti ka kërkuar tu njihet kjo e drejtë në bazë të pagës neto të cilën e merr e jo në bazë të pagës bazë, për të cilën u njihet kjo e drejtë nga Kontrata Kolektive e lartcekur. Konkretisht, sa i përket pagës bazë gjykata është bazuar në përgjigjen e kthyer nga ana e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me numër të protokollit 4540 të datës 11.12.2023, me të cilën është vërtetuar fakti se punëtori teknik e ka pagën bazë prej 271.55 euro. Me nenin 55 paragrafi 2 i Ligjit të Punës, është paraparë se *“Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës”*. Pra përcaktimi ligjor nga ky nen, ndan atë çka nënkupton pagë dhe shtesa nga paga.

Lidhur me kundërshtimet e të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike.

Rrjedhimisht, Gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritator. Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë 22.12.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro, si dhe taksës gjyqësore prej 21.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 125 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:293460, 21.02.2025

B. Profesional
Leonit Çoçaj

Gjyqtari

Agron Karatash

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.